
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: Smart X Industries SH.P.K. me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	22.04.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **20.04.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Smart X Industries SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Digjitalizimi i shkollave me pajisje moderne, laboratorë të pajisur me teknologji të reja**, me Numër të prokurimit: **623-26-2224-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-006-1-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si *pjesërisht* e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Smart X Industries SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Digjitalizimi i shkollave me pajisje moderne, laboratorë të pajisur me teknologji të reja**, me Numër të prokurimit: **623-26-2224-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-006-1-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **15.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Digjitalizimi i shkollave me pajisje moderne, laboratorë të pajisur me teknologji të reja**, me Numër të prokurimit: **623-26-2224-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-006-1-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Smart X Industries SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Digjitalizimi i shkollave me pajisje moderne, laboratorë të pajisur me teknologji të reja**, me Numër të prokurimit: **623-26-2224-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-006-1-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **15.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks.gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **20.04.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Pasi që e kemi analizuar dosjen e tenderit dhe paramasën e këtij aktiviteti të prokurimit, kemi ardh në përfundim që autoriteti kontraktues ka vepruar në mënyrë diskriminuese dhe jo në harmoni me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit, për faktin se lista e artikujve të përfshirë në këtë aktivitet të prokurimit përmban furnizime të natyrave të ndryshme, të cilat nuk kanë lidhje funksionale dhe logjike ndërmjet tyre, duke e bërë të pajustificueshme përfshirjen e tyre në një lot të vetëm.

Në kuadër të këtij tenderi autoriteti kontraktues ka përfshirë:

Pajisje digjitale dhe teknologjike, si:

Projektorë, smart panel interaktivë, monitorë All-in-One, skanerë portativë, pajisje ëireless dhe ekrane projektuese;

Pajisje laboratorike, si:

Mikroskopë digjitalë, sensorë laboratorikë dhe pajisje për eksperimente;

Inventar i jashtëm dhe pajisje urbane, si:

Banka betoni, shporta për mbeturina, kontejnerë riciklimi, vazo dekorative dhe elemente të tjera të infrastrukturës së jashtme.

Përfshirja e këtyre artikujve në një lot të vetëm bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe të konkurrencës së drejtë, pasi operatorët ekonomikë që merren me furnizim të pajisjeve teknologjike nuk janë domosdoshmërisht furnizues të inventarit apo pajisjeve laboratorike, dhe anasjelltas.

Kjo mënyrë e hartimit të dosjes së tenderit kufizon në maksimum konkurrencën, pasi që përfshirja në një lot të vetëm i furnizimeve të natyrave të ndryshme pamundëson pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të specializuar sipas fushave përkatëse.

Përfshirja në të njëjtin lot e pajisjeve teknologjike për digjitalizim, pajisjeve laboratorike dhe inventarit urban favorizon operatorë të caktuar ekonomikë që mund të kryejnë furnizime të ndryshme jo të ndërlidhura, duke kufizuar kështu pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë që janë të specializuar vetëm në një nga këto fusha.

P.sh: Një furnizues i pajisjeve teknologjike, si smart panelë dhe projektorë, zakonisht nuk merret me furnizimin e bankave të betonit apo kontejnerëve për mbeturina, ndërsa një kompani që merret me inventar urban zakonisht nuk furnizon pajisje laboratorike apo pajisje digjitale për shkolla. Si përfundim, kjo mënyrë e grupimit krijon pabarazi në trajtim dhe zvogëlon mundësinë për konkurrencë reale dhe efektive.

Për më tepër, përfshirja e artikujve si bankat e betonit, kontejnerët dhe pajisjet e tjera të jashtme nuk përputhet me objektin dhe titullin e aktivitetit të prokurimit *“Digjitalizimi i shkollave me pajisje moderne, laboratorë të pajisur me teknologji të reja”*, pasi këto artikuj nuk kanë lidhje funksionale me digjitalizimin e shkollave apo me laboratorët teknologjikë.

Si përfundim hartimi i dosjes së tenderit dhe listës së çmimeve në këtë mënyrë siç ka vepruar autoriteti kontraktues nuk është në harmoni me objektin e kontratës, sepse kufizon konkurrencën, krijon pabarazi ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe mund të rezultojë në favorizim të operatorëve të caktuar, duke cenuar transparencën dhe barazinë në procedurën e prokurimit.

Kur kemi parasysh këto fakte, ne kërkojmë që të bëhet ndryshimi i listës së çmimeve duke e bërë ndarjen në lote të veçanta për produktet e natyrave të ndryshme, sepse në të kundërtën nëse një gjë e tillë nuk ndodh, atëherë ne jemi të detyruar të vazhdojmë me ankimmime edhe në instancat tjera më të larta, pasi që në këtë mënyrë po favorizohet një OE i caktuar i cili mund të bëjë furnizimet e tilla.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Në përputhje me paragrafin 2 të nenit 24 të LPP-së, **“Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”**.

Po ashtu në përputhje me paragrafin 2 të nenit 7 të LPP-së, **“Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik”**.

Sa i përket pretendimit tuaj ankimor se objekti i kontratës nuk përputhet me titullin e aktivitetit të prokurimit, NUK qëndron dhe është i pa bazuar, sepse në fillim të titullit ceket: *Digjitalizimi i shkollave me pajisje moderne*, që nënkupton se përfshihen të gjitha pajisje të nevojshme për shkollat e Komunës.

Njësia Kërkuese ka përgatitur **specifikimet teknike**, në pajtim me Nenin 28 të LPP dhe Nenin 19 të kësaj rregullore.

Po ashtu sa i përket pretendimit tuaj se kërkoni që të bëhet ndryshimi i listës së çmimeve duhet e bërë ndarjen në lote të veçanta për produktet e natyrave të ndryshme, është i pa bazuar, sepse **tek Përshkrimi i Çmimeve janë vetëm 18 pozicionet të kërkuara**, dhe ne si Autoritet Kontraktues, e kemi përdorur metodën me efektive dhe me efikase sipas Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregullores për Prokurim Publik, e cila është: **Çmimin më të ulët me poentim**, duke i dhënë **peshën dhe rëndësinë në përqindje produkteve të kërkuara**.

Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Në dosje të tenderit është kërkuar **“BE EN 13331-1-2002 (Certifikata për Sistemet e rreshtimit të Specifikimeve të produktit)”**.

Kjo certifikatë nuk është relevante për aktivitetin e prokurimit me objekt *“Digjitalizimi i shkollave me pajisje moderne, laboratorë të pajisur me teknologji të reja”*, pasi që **standardi BE EN 13331-1:2002 lidhet me sistemet mbështetëse për gërmime dhe punime ndërtimore, përkatësisht me pajisje të përdorura në sektorin e ndërtimit për sigurimin e kanaleve dhe gropimeve**.

Kur kemi parasysh faktin se ky aktivitet prokurimi ka të bëjë me furnizim të pajisjeve teknologjike, laboratorike dhe inventar shkollor, kërkesa për këtë certifikatë nuk ka lidhje me natyrën e furnizimit dhe as me kapacitetin teknik të operatorëve ekonomikë për realizimin e kontratës. Vendorsja e kësaj kërkesë është jo proporcionale dhe kufizon konkurrencën, pasi që ju pamundëson ofertimin operatorëve ekonomik të interesuar për ofertim të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e furnizimit me pajisje teknologjike dhe laboratorike, por që nuk posedojnë një certifikatë të natyrës ndërtimore, e cila nuk ndikon në cilësinë apo realizimin e furnizimit të kërkuar. Për këtë arsye, kërkesa për certifikatën BE EN 13331-1:2002 është jorelevante me objektin e kontratës, andaj kërkojmë që e njëjta të largohet në tërësi nga dosja e tenderit, me qëllim të hapjes së konkurrencës dhe të mos favorizimit të ndonjë OE të caktuar.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i bazuara

AK: Komuna e Rahovecit ka bërë korrigjimet sipas Formularit për korrigjim të gabimeve B54, i publikuar në e-prokurim, me datë: 22.04.2026;

Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

Në dosje të tenderit po ashtu është kërkuar “ISO 20000-1 (Certifikata Teknologjia e informacionit)”. Kjo certifikatë nuk është relevante për këtë aktivitet të prokurimit pasi që standardi ISO 20000-1 ka të bëjë me menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë informative, respektivisht me organizimin dhe ofrimin e shërbimeve IT, si mirëmbajtja e sistemeve, menaxhimi i infrastrukturës IT dhe ofrimi i shërbimeve të vazhdueshme teknologjike. Ndërsa në këtë aktivitet prokurimi objekti kryesor është furnizimi me pajisje teknologjike, laboratorike dhe inventar shkollor, e jo ofrimi i shërbimeve të menaxhuara të teknologjisë informative. Për këtë arsye, kërkimi i kësaj certifikate nuk lidhet drejtpërdrejt me natyrën e kontratës dhe nuk dëshmon aftësinë e operatorit ekonomik për të realizuar furnizimin e kërkuar. Vendosja e këtij kriteri krijon kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë që kanë kapacitetin profesional dhe teknik për furnizimin e pajisjeve të kërkuara, por që nuk posedojnë certifikim për menaxhim të shërbimeve IT, i cili nuk është i domosdoshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Prandaj kërkojmë që kërkesa për ISO 20000-1, të largohet nga dosja e tenderit për faktin se e njëjta nuk është relevante për këtë aktivitet të prokurimit, përkatësisht e njëjta nuk është në harmoni me objektin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Në dosje të tenderit po ashtu është kërkuar “Tre (3) persona të certifikuar për instalimin dhe kalibrimin e tabelave interaktive lëshuar nga prodhuesi..., me së paku pesë (5) vite përvojë pune...”. Kjo kërkesë është e ekzagjeruar dhe jo proporcionale me objektin e kontratës, pasi për furnizimin dhe instalimin e tabelave interaktive nuk është e nevojshme të kërkohen tre persona me certifikim nga prodhuesi dhe me pesë vite përvojë në menaxhim projektesh. Për të garantuar realizimin e kontratës mjafton të kërkohet një (1) person i certifikuar për instalimin e tabelave interaktive, me përvojë relevante profesionale, pa vendosur kriterë të panevojshme që kufizojnë konkurrencën. Prandaj kjo kërkesë duhet të ndryshohet sipas kërkesës tonë.

Në dosje të tenderit po ashtu është kërkuar “Një (1) person të Teknologjisë Informative i certifikuar dhe i licencuar si instalues dhe optimizues i moduleve të digjitalizimit...”. Kjo kërkesë nuk është e qartë dhe nuk specifikon standardin apo institucionin që lëshon licencimin e kërkuar, duke e bërë kriterin jo transparent dhe vështirë të verifikueshëm. Për realizimin e kontratës mjafton të kërkohet një (1) person i fushës së IT-së me përvojë profesionale relevante në instalimin e pajisjeve teknologjike, pa kërkesa të paqarta për licencime të paspecifikuara. Prandaj kjo kërkesë duhet të ndryshohet dhe riformulohet qartë dhe në përputhje me natyrën e kontratës.

Në dosje të tenderit po ashtu është kërkuar “Inxhinier i Diplomuar ose Bachelor në Inxhinieri Softuerike (IT)... i certifikuar në Cisco Certified Network Associate (CCNA)...”. Kjo kërkesë është më e lartë se sa kërkohet për realizimin e këtij furnizimi, pasi certifikimi CCNA lidhet me administrimin dhe konfigurimin e rrjeteve kompjuterike, ndërsa objekti i kontratës ka të bëjë me furnizim dhe instalim të pajisjeve digjitale dhe laboratorike. Për realizimin e kontratës mjafton të kërkohet një inxhinier ose teknik i fushës së IT-së me përvojë relevante profesionale, pa kushtëzuar certifikim specifik në rrjete kompjuterike. Prandaj kjo kërkesë duhet të ndryshohet, modifikohet dhe të përshtatet me natyrën reale të aktivitetit të prokurimit.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

Pretendimi ankimor te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale NUK qëndron ngase përcaktimi i këtyre kritereve, të këtyre kërkesave ka të bëjë lëndën së natyrës së Projektit në fjalë, dhe gjithashtu një kërkesë e tillë është e domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit në fjalë.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura, Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmimeve është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi në pajtueshmëri me objektin e kontratës. **Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë sa i përket Kërkesave dhe dëshmimeve mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik

AK: Komuna e Rahovecit, me rastin e vendosjes së kritereve apo kërkesave kualifikuese ka kërkuar vetëm ato **kërkesat dhe dëshmitë që janë ngushtë të lidhura** me sigurimin e cilësisë dhe kualitetit të lëndës së prokurimit/ **shiko Interpretimin Nr. 26 të dt. 09.06.2023**.

Kërkesa janë absolutisht te domosdoshme për të konfirmuar nëse Operatori Ekonomik potencial, ka kapacitetin e nevojshme teknik dhe profesional për të realizuar këtë projekt me sukses, në mënyrë efektive dhe efektive. Duhet theksuar faktin që këto pajisje teknologjike do të përdoren në shkolla nga nxënësit dhe stafi arsimor prandaj duhet evituar të gjitha mundësit për dështimin e projektit apo realizimin e projekteve në mënyrë joprofesionale qoftë pjesërisht apo plotësisht.

Këto kërkesat/dëshmitë kanë qenë të monitoruara nga **KRPP Departamenti i Monitorimit**, ku neve si Autoritet Kontraktues nga ka dhënë **Rekomandimet** për kriteret diskriminuese apo kufizuese, ku ato rekomandimin i kemi pranuar si të bazuar dhe me **Formularit për korrigjim të gabimeve** janë larguar nga Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit.

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara

Pretendimi Nr. 4 Ankimor:

Në dosje të tenderit po ashtu është kërkuar “**Menaxheri i Projektit një (1) person i certifikuar nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), për mbrojtje nga zjarri...**”. Kjo kërkesë nuk ka lidhje me objektin e aktivitetit të prokurimit, pasi certifikimi për mbrojtje nga zjarri nuk ndikon në furnizimin dhe instalimin e pajisjeve teknologjike dhe laboratorike të kërkuara në këtë tender. Vendosja e këtij kriteri është jorelevante dhe kufizon pa arsye konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Prandaj kjo kërkesë duhet të largohet në tërësi nga dosja e tenderit.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 4 Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i bazuara

AK: Komuna e Rahovecit ka bërë korrigjimet sipas **Formularit për korrigjim të gabimeve B54**, i publikuar në e-prokurim, me datë: **22.04.2026**;

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitive të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>